



RRJETI PËR
MBROJTJEN
E NATYRËS

Raporti i vlerësimit dhe informimit për 9 rajonet
pilote të monitorimit të pjesëmarrjes publike dhe
përfshirjes së OJF-ve në strukturat vendimmarrëse

Tetor 2018

Ky raport është përgatitur nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në kuadër të projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura", si pjesë e Programit "Mbështetje për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Shqipëri SENIOR-II, i cili zbatohet nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC Shqipëri) dhe financohet nga Qeveria Suedeze.

Përmbajtja e Raportit të Vleresimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Qeverisë Suedeze dhe/apo të REC Shqipëri.

Ky raport ka në përmbajtjen e tij Vlerësimet dhe rekomandimet të monitorimit të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes së OJF-ve në strukturat vendimmarrëse për 16 zona të mbrojtura në rajonet pilote të përzgjedhura: Tiranë (Tiranë, Dibër), Vlorë (Vlorë), Gjirokastër (Përmet, Dropull), Korçë (Korçë, Pustec), Mat (Ulëz), Durrës (Krujë), Kukës (Kukës, Tropojë), Shkodër (Shkodër, Malësia e Madhe), Elbasan (Librazhd) dhe Fier (Divjakë).

Gjatë këtij procesi vlerësim-analizimi u punua për advokimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje si një shtyllë e rëndësishme që qëndron në themel të mirëfunksionimit të një sistemi demokratik.





Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) është një organizatë jo qeveritare, e regjistruar si e tillë nga Gjykata e Tiranës në vitin 2004, me vendimin nr. 1087. INCA ka zyrën e saj në Tiranë, por vepron në të gjithë territorin e Shqipërisë.

INCA ka si qëllim kryesor të japë ndihmesën e saj në fushën e formimit profesional, nëpërmjet trajnimeve dhe procesit të pjesëmarrjes, në ruajtjen e mjedisit, në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin rajonal, mbrojtjen e florës dhe të faunës, vlerësimin e diversitetit biologjik, menaxhimin e zonave të mbrojtura, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe vendimmarrësve politik, dhe të ndërmarre masa mbrojtëse kur është e mundur dhe e nevojshme për mbrojtjen e llojeve dhe habitateve të tyre kritike.

Gjithashtu të integrojë ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit me çështjet e tjera ose fusha të shkencës që kanë një ndikim në burimet natyrore. INCA është pjesë e procesit të përmirësimit të legjislacionit, të problematikave të lidhura me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve mjedisore Shqiptare, si dhe integrimin Evropian.

Hyrje

Demokracia vendore lidhet ngushtësisht me mirëqeverisjen në nivelin vendor.

Mirëqeverisja udhëhiqet nga parimet dhe funksionimi i transparencës së organeve të njësisë të qeverisjes vendore, përgjegjshmërisë së tyre, llogaridhënies, ushtrimit të pjesëmarrjes qytetare, efektivitetit të politikave publike në nivel vendor dhe efikasitetit në raport me burimet në dispozicion.

Vëmendja në këtë raport i kushtohet jo vetëm funksionimit të mekanizmave të ngritur në nivel strukturash vendimmarrës për përfshirjen e publikut por edhe rolit të shoqërisë civile në tërësi, të medias, si dhe evidentimin e mundësive për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Metoda e përgjithshme e përdorur është kombinimi i të dhënave të disponueshme dhe informacioneve nga burime primare dhe sekondare me të dhënat e marra nga anketimi i kryer (sondazhe dhe pyetësor) me qëllim mbledhjen e informacionit mbi përfshirjen e pjesëmarrjes publike.

Pamje e pergjithshme e legjislacionit

Baza ligjore:

- Nenet 23, 48 dhe 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Nenet 51 - 55 të Kodit të Procedurave Administrative.
- Ligji Nr. 8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".
- Ligji Nr. 8672, datë 26.10.2000 "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çeshtjet e mjedisit" (Konventa e Aarhus-it).
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- Ligji Nr. 81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura".
- Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- VKM Nr. 994, datë 02.07.2008 "Vendim i Këshillit të Ministrave për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin".
- VKM Nr.16, datë 04.01.2012 "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor".

Gjëndja aktuale

Si shumë vende në tranzicion, Shqipëria përballet me një nevojë urgjente për të zhvilluar dhe forcuar sisteme dhe praktika të përshtatshme për të nxitur pjesëmarrjen publike.

Në çështjet bazë të qeverisjes vendore, për të dy zonat e mbrojtura marra në konsideratë nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), konstatohet një pjesëmarrje e ulët e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Jo vetëm në diskutime të lira dhe tryeza të rrumbullakëta me aktorë të ndryshëm, por edhe pas sondazheve të realizuara në kuadër të projektit vërehet një përpjekje jo sistematike dhe jo e qëndrueshme në procese vendim-marrëse nga ana e publikut.

Procesi i mospërfshirjes së publikut vjen gjithashtu si rrjedhojë e mungesës të formulimit të politikave të qëndrueshme nga institucionet përgjegjëse.

Shumë institucione nuk i kanë kapacitetet e mjaftueshme për të kryer konsultime publike të qëndrueshme. Nuk kanë të zhvilluar kapacitetet për pranimin e publikut në procese vendimmarrëse, kjo gjë u vërtetua gjatë gjithë jetës së projektit mes pushtetit vendor në Bashkitë e zonave pilote dhe grupimeve të aktorëve të interesuar, sic janë forumet lokale mjedisore.

Në fazën e parë të implementimit të projektit, INCA ka organizuar takime paraprake me përfaqësues të Administratës dhe përfaqësues të grupeve të shoqërisë civile, për të lehtësuar dialogun dhe vendosur urat e komunikimit dhe zbatimit të projektit.

Gjatë këtyre takimeve u vu re nevoja e rritjes së përgjegjshmërisë së qeverisjes vendore duke e bërë veprimtarinë e institucioneve dhe përfaqësuesve në këtë nivel më transparente.

Shpesh herë mbledhjet e Këshillave Bashkiakë nuk respektojnë parimet e qëndrueshmërisë institucionale. Informimi i publikut mbi vendimet e Këshillave Bashkiak bëhet pranë bashkive dhe në disa raste edhe në faqet on-line, kurse njoftimi për mbledhjet e tyre nuk njoftohet rregullisht në vende të aksesueshme nga publiku.

Nga ana tjetër, organizatat e shoqërisë civile kanë nevojë për të zhvilluar më tej kapacitetet e tyre advokuese, bashkëpunuese dhe monitoruese.

Qëllimi dhe Objektivat

Projekti zgjati shtatë muaj dhe ka përfshirë strukturat ligjzbatues të fushës së natyrës në nivel qendror si MM dhe AKZM, dhe në nivel lokal AdRZM-të dhe pushteti vendor, si dhe partneritetin mes tyre në iniciativa të përbashkëta dhe aktivitete që kanë për qëllim promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Qëllimi kryesor i projektit është të forcojë rolin pjesëmarrës dhe advokues të shoqërisë civile në promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veçanërisht Zonave të Mbrojtura. Risia e këtij projekti konsistoi në krijimin e grupimeve lokale për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore.



Nëpërmjet këtij projekti u synua një përfaqëse strategjike e angazhimit të shoqërisë civile në adresimin afatgjatë të advokimit dhe promovimit të vlerave kryesore në 16 Zona të Mbrojtura Mjedisore (ZMM) të përzgjedhura në rajonet: Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Mat, Kukës, Shkodër, Elbasan dhe Fier.

Në strategjinë e hartuar për Rrjetin e Mbrojtjes së Natyrës "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura", synohet një përfaqëse strategjike në adresimin afatgjatë të problematikës dhe të nevojave të rrjetit si dhe ngritja dhe zhvillimi i një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen Zonat e Mbrojtura Mjedisore (ZMM) të përzgjedhura në rajonet: Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Mat, Durrës, Kukës, Shkodër, Elbasan dhe Fier.

Një aspekt i rëndësishëm në Strategjinë e RrMN është "Rritja e Kapaciteteve të OMSHC-ve", për një veprim më efektiv, duke u ofruar atyre njohuri të reja, metodologji e teknika bashkëkohore, si edhe mundësi për shkëmbime e njohuri praktike. Është e qartë se organizimi i dobët dhe pozicionimi jo i duhur i tyre, mungesa e kapaciteteve dhe e logjistikës në kontekstin lokal, mendohet të jenë disa prej faktorëve që kontribuojnë në mungesën e efikasitetit dhe të jetë gjatësisë së tyre.

Emri i Organizatës: **Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri-(INCA)**

Zona ku është zbatuar projekti:

Qarku Fier, Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta

Qarku Elbasan, Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë

Për të rritur kapacitetet e anëtarëve të rrjetit INCA publikoi një metodologji; "Për mënyrat më të mira të komunikimit, advokimit, lobimit dhe pjesëmarrjes publike".

- Udhëzuesi "PËR MËNYRAT MË TË MIRA TË KOMUNIKIMIT, ADVOKIMIT, LOBIMIT DHE PJESEMARRJES PUBLIKE"



Kjo metodologji përfshin konceptet, rastet dhe praktikatat me të mira për advokim, lobim, dhe metoda të tjera të zbatimit të presionit publik në procesin e vendimarrjes si në menaxhimin e ZM ashtu edhe në hartimin dhe zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore duke pasur në fokus përdorimin dhe ruajtjen e qëndrueshme të burimeve natyrore.

- Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të aktoreve gjithëpërfshirës në ZM duke krijuar FORUME LOKALE MJEDISORE.

Projekti në fazën e dytë vijoi bazuar në një analizë të thellë të rezultateve të impakteve negative në ZM pilote zbatuar nga Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri. INCA informoi dhe synoi në ndërgjegjësimin e anëtarëve të forumit mbi problematikat e vrejtura dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi. Në



bashkëpunim me forumin lokal u punua për fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në advokimin e rekomandimeve mbi zgjidhjen e problematikave të identifikuara në ZM pilote. Ngritja e forumeve lokale mjedisore është gjithashtu një strukturë e gatëshme profesionale për propozimin e rrugëve/mënyrave novatore për të adresuar çështjet e mjedisit në përgjithësi për mirëmenaxhimin e ZM, për të hapur dialogun dhe propozuar bashkëpunime në nivel vendor.

- Takime konsultuese/informuese dhe advokuese me aktorët e interesuar dhe strukturat lokale vendimmarrëse



INCA ka nxitur dhe udhëhequr organizimin dhe realizimin e disa takimeve informuese dhe advokuese me aktorët lokal (AKZM, ADZM, Inspektoriat Mjedisore, Bashkive dhe Njësi Administrative) si dhe grupe të interesit komunitet lokal, përdorues të burimeve natyrore, bizneseve private, dhe të autoritete vendore, në Divjake-Karavasta dhe Librazhd.

Tematika e këtyre takimeve ishte diskutimi i vlerave të burimeve natyrore lokale dhe ndarja e barabartë e përfitimeve nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, roli informues dhe mbështetës me ekspertizë teknike i Forumit dhe RrjMN, informimi i tyre mbi gjetjet, vlerësimet dhe advokimi mbi rekomandimet për minimizimin e impakteve negative në zonat e studjuara.

- Realizimi i disa sondazheve për vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes publike në takimet lokale vendimmarrëse për përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore

Në bashkëpunim me forumet mjedisore lokale të ngritura INCA realizoi disa sondazhe dhe anketime me grupet kryesore të interesit në nivel lokal për të analizuar dhe vlerësuar situatën faktike të pjesëmarrjes së tyre në vendimarrjen lokale me fokus përdorimin e burimeve natyrore në rajonet pilote të marra në konsideratë. Analizimi i gjetjeve të fazës së parë dhe nevojave të identifikuara, si dhe ndarja e bërja publike e tyre në nivel lokal me drejtues dhe staf të bashkive të përfshira në projekt, përmes organizimit të 6 takimeve në 2 ZM.

- Nxitja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe komunitetit lokal drejt një procesi bashkëpunimi për promovimin e përbashkët të ZM

- ✓ U realizua një aktivitet ndërgjegjësues dhe edukues masiv me rastin e Ditës së Tokës me 22 Prill në Parkun Kombëtar të Divjake Karavasta. Aktiviteti ishte i përbashkët me kontributin e të gjithë RrjMN.





- ✓ U promovua "Ruajtja e natyres, përdorimi i qëndrueshëm i burimeve dhe vlerave natyrore të ZMM dhe nxitja e aktiviteteve të ekoturizmit me baze natyrën", nepermjet aktivitete edukuese me shkollat e zonave pranë ZM

- ✓ U bë e mundur mbjellja e pishave (rreth 4500 fidane pisha e bute nga të cilat 1000 fidane nga INCA)
- ✓ U bë i mundur pastrimi i territorit pranë plazhit të Divjakës
- Vitalizimi i Qendrës së Vizitorëve në PK "Divjakë-Karavasta"



U organizua një program trajnimi një ditor mbi interpretimin e vlerave dhe shërbimeve të ekosistemeve natyrore si dhe modelet e aktiviteteve edukuese dhe ekoturistike me bazë natyrën.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, grupimi i Rrjetit për mbrojtjen e natyrës në Shqipëri u trajnuan mbi interpretimin e vlerave dhe shërbimeve të ekosistemeve natyrore ndërsa përfaqësuesit e Administratës Rajonale të zonave të mbrojtura u trajnuan mbi krijimin e modeleve të reja të aktiviteteve edukuese dhe ekoturistike me baze natyrën.

- Ndërmarrja e disa iniciativave për prononcime në medianë e shkruar dhe atë vizive.



Që në fillim të projektit u kërkua që media të angazhohet dhe të mbështesë aktivitetet duke pasqyruar aktivitetet promovuese por edhe advokuese të zonave pilote me kronika të vazhdueshme dhe emisione të dedikuara për projektin.

- Identifikimi i arritjeve dhe sfidave e bëra publike e tyre në konferencën kombëtar *"Prezantimi i vlerësimeve dhe të rekomandimeve të monitorimit të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes së organizatave të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës (RrMN) në vendimmarrje për një menaxhim të qëndrueshëm e shumëpërdorimshëm të Zonave të Mbrojtura Mjedisore"*, me pjesëmarrjen e rreth 60 përfaqësuesve të pushtetit vendor, shoqërisë civile, donatorëve që punojnë në fushën e mjedisit dhe ZM vecanerisht.
- Angazhimi i ORrMN u mbështetet nga media, e cila është një tjetër palë e rëndësishme e një shoqërie demokratike. **Media** pasqyroi aktivitetet promovuese por edhe advokuese të zonave pilote me kronika të vazhdueshme dhe emisione të dedikuara të projektit.

Analiza e sondazheve nepermjet takimeve direkte

Në kuadër të promovimit dhe advokimit të vlerave dhe burimeve natyrore, fuqizimit të demokracisë në vendimmarrjen vendore në Bashkitë Librazhd dhe Bashkinë Divjakë u realizuan takime nga grupet e punës së projektit me asistencën e stafit të INCA-s dhe përfaqesues të Forumit Lokal mjedisor me qëllim ndarjen e informacioneve rreth projektit, nismës së RrMN, programit SENiOR II dhe gjithashtu nxitjen e transparencës publike, përmirësimit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së Qeverisjes Vendore.

Bashkitë e 2 zonave të marra në studim kanë qenë gjithnjë të angazhuara në realizimin e planit të komunitetit dhe në ndërmarrjen e nismave që çojnë më tej zhvillimin komunitar. E megjithatë ky process ka ende mangësite e tij.



Kapacitetet e administratës për të aplikuar metoda të qeverisjes me pjesëmarrje dhe **edukimi qytetar** mbi të drejtat dhe përgjegjësitë për të marrë pjesë në vendimmarrje shënojnë ende nivele të ulta.



Analiza e të Dhënave/Pyetësoni

Nëpërmjet këtij projekti u bë i mundur zhvillimi i mekanizmave për të monitoruar dhe vlerësuar suksesin e procedurave të përfshirjes në vendimmarrje në nivel vendor të komuniteteve dhe aktorëve të tjerë të interesuar në përdorimin, promovimin e burimeve natyrore.

Vlerësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse u realizua përmes një studimi organizuar me 50 intervista dhe pyetësorë me përfaqësues të komunitetit.

Ndërsa vlerësimi i trajtimit të çështjeve të mjedisit në mbledhjet e Këshillit Bashkiak u realizua me takime direkte me aktorë të ndryshëm të pushtetit vendor, institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile në Bashkitë Librazhd dhe Divjakë.

Që të ndërtohen rezultate dhe rekomandime sa më të mira dhe gjithëpërfshirëse është shumë e rëndësishme të kihen disa tregues të matshëm mbi njohuritë që kanë qytetarët mbi legjislacionin e Zonave të Mbrojtura dhe në mënyrë të veçantë mbi perceptimin që kanë ata në mënyrën e përfshirjes së tyre në procesin e implementimit të tij.

Në këtë kuadër ky pyetësor synon të nxjerri disa konkluzione konkrete mbi perceptimin e qytetarëve të Librazhdit dhe Divjakës për të drejtën e përfshirjes publike në procese vendimmarrëse.

Seksioni i parë përmbante pyetje të përgjithshme të cilat synonin të mblidhnin të dhëna bazë mbi të anketuarit (si psh. grupi të cilit i përkisnin, mosha, gjinia dhe niveli i edukimit) si dhe disa vlerësime të përgjithshme nga ana e të anketuarve mbi Legjislacionin në fuqi për Zonat e Mbrojtura.

Përmes pyetjeve specifike, të anketuarit kishin mundësinë të reflektonin sa familjarë ata ishin me aspektet e ndryshme të shërbimeve të ofruara nga Bashkia apo cdo institucion tjetër në lidhje me burimet natyrore të cdo zone.

Rezultoi që në nivel vendor nuk kishte kapacitete dhe iniciativa të mjaftueshme për të përfshirë publikun në procese vendimmarrëse, por gjithashtu vërehet një përpjekje jo e qëndrueshme e publikut për çështje të ndryshme në fushën e mjedisit në përgjithësi.


1. Në tabelën 1 jepet informacion për gjininë dhe arsimin e pjesëmarrësve.

Arsimi i të intervistuarve në PKDK		Gjinia		Arsimi i të intervistuarve në PKSHJ		Gjinia	
I larte	8	F 6	M 19	I larte	15	F 9	M 16
I mesem	17			I mesem	10		


Tabela 1. Gjinia dhe arsimi i pjesëmarrësve

Rezultatet e pyetësorëve për Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta

1. Cilit grupi i përkisni?



2. Në dijeninë tuaj a e përmban legjislacioni përfshirjen publike në menaxhimin e zonave të mbrojtura?



3. Nëse po, ju lutemi përshkruani fushat dhe proceset e nevojshme për përfshirjen e publikut?




4. Si realizohet kjo përfshirje publike?

Përgjigjet e të intervistuarve;

- ✓ *Nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak,*
- ✓ *Nëpërmjet pjesëmarrjes në takime të organizuara nga Administrata e Zonave të Mbrojtura*
- ✓ *Nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet e shoqatave jo qeveritare,*
- ✓ *Nëpërmjet pjesëmarrjes në dëgjesa publike,*

5. A keni marrë pjesë në takimet e organizuara nga Këshilli Bashkiak për problemet e mjedisit?



6. Nga e keni marrë njoftimin për këtë mbledhje?

✓ *Nëpërmjet bisedave me miqtë.*

7. Cilat kanë qenë tematikat e diskutuara?

✓ *Zjarrëveniet*

8. A keni dorëzuar kërkesa/ankesa në lidhje me problematikat e mjedisit dhe veçanërisht për mirëadministrimin e parkut kombëtar?



9. Ju lutemi listoni në mënyrë prioritare arsyet për përfshirjen tuaj në mirëmenaxhimin e Zonës së Mbrojtur.

- ✓ Ruajtja e Zonës së Mbrojtur
- ✓ Mbajtja paster e mjedisit,
- ✓ Mbjellja e fidaneve,
- ✓ Zhvillimi i turizmit,
- ✓ Rritja e prodhimit vendas
- ✓ Rritja ekonomike


10. A është komuniteti juaj aktiv që kërkon të rrisë pjesëmarrjen publike në menaxhimin e zonës së mbrojtur?




11. Nëse po, cilat janë disa nga strategjitë që po përdoren?

- ✓ Kërkesë për pjesëmarrje në mbledhjet me Keshillin Bashkiak
- ✓ Kërkesë për pjesëmarrje në takimet e organizuara nga Administrata e Parkut Kombëtar
- ✓ Kërkesë për pjesëmarrje në takime dhe tryeza të organizuara nga shoqatat e shoqërisë civile

12. A ka zona ku jetoni, një grup "Forumi local mjedisor", ose grupe individuale "Miq të Parkut"?



13. Nëse po, a kontribuoni ju me resurse ndaj grupit / grupeve, dhe / ose ndihmoni me administratën dhe menaxhimin e këtyre forumeve?




14. Nëse po, ju lutemi shkruani llojin dhe shtrirjen e kontributit.


- ✓ Fushate ndëgjegjesimi në rrjete sociale
- ✓ Pjesëmarrje në takime me kryetarin e forumit
- ✓ Diskutime me komunitetin për ruajtjen dhe mbajtjen pastër të mjedisit.

Rezultatet e pyetësorëve për Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë


1. Cilit grupi i përkisni?



2. Në dijeninë tuaj a e përmban legjislacioni përfshirjen publike në menaxhimin e zonave të mbrojtura?




3. Nëse po, ju lutemi përshkruani fushat dhe proceset e nevojshme për përfshirjen e publikut.



4. Si realizohet kjo përfshirje publike?

- ✓ *Nepërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak,*
- ✓ *Nepërmjet pjesëmarrjes në takime të organizuara nga Administrata e Zonave të Mbrojtura*
- ✓ *Nepërmjet pjesëmarrjes në takimet e shoqatave jo qeveritare,*
- ✓ *Nepërmjet pjesëmarrjes në degjese publike*

5. A keni marrë pjesë në takimet e organizuara nga Këshilli Bashkiak për problemet e mjedisit?




6. Nga e keni marrë njoftimin për këtë mbledhje?

- ✓ *Nga njohjet me anëtarë të Keshillit Bashkiak*

7. Cilat kanë qenë tematikat e diskutuara?

- ✓ *Cështja e mbetjeve urbane*
- ✓ *Sistemi i gjobave për ndotësit*

8. A keni dorëzuar kërkesa/ankesa në lidhje me problematikat e mjedisit dhe veçanërisht për mirëadministrimin e parkut kombëtar?




1 Ankese per vendosjen e koshave te mbetjeve ne lagje dhe nuk ka marre pergjigje.....

9. Ju lutemi listoni në mënyrë prioritare arsyet për përfshirjen tuaj në mirëmenaxhimin e zonës së mbrojtur.

- ✓ *Menaxhimi i mbetjeve,*
- ✓ *Parandalimi i ndotjes,*
- ✓ *Promovimi dhe mbrojtja e vlerave të parkut*
- ✓ *Rritja e vizitoreve*
- ✓ *Rritja ekonomike e vendasve*


10.A është komuniteti juaj aktiv që kërkon të rrisë pjesëmarrjen publike në menaxhimin e zonës së mbrojtur?




11.Nëse po, cilat janë disa nga strategjitë që po përdoren?

- ✓ *Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme,*
- ✓ *Diskutime me studente*
- ✓ *Thirrje në rrjete sociale*

12.A ka zona ku jetoni, një grup "Forumi local mjedisor", ose grupe individuale "Miq të Parkut"?



13. Nëse po, a kontribuoni ju me resurse ndaj grupit / grupeve, dhe / ose ndihmon me administratën dhe menaxhimin?



14. Nëse po, ju lutemi shkruani llojin dhe shtrirjen e kontributit.

- ✓ Ndergjegjesim te komunitetit,
- ✓ Pjesemarrje në takime
- ✓ Pjesemarrje ne fushata te pastrimit



RRJETI PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Rrjeti Tematik në fushën e "**Mbrojtjes së Natyrës**", përfaqësohet nga tetë OJF mjedisore:

Organizata Drejtuese	"Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri", Tiranë.
Organizata	"Forumi Ndërkufitar i Liqenit të Shkodrës", Shkodër.
Organizata	"ILIRIA", Tiranë.
Organizata	"Miqësia", Ulëz.
Organizata	"Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit", Kukës.
Organizata	"Green and Clean", Korçë.
Organizata	"Mjedisore Çajupi", Gjirokastrë.
Organizata	"Flag Pine", Vlorë.

❖ Organizata "Miqësia Ulëz"



Gjate realizimit të këtij programi janë realizuar disa aktivitete advokuese si dhe takime informuese pranë bashkive për të dy ZM në bashkëpunim me rrjetin e organizatave lokale dhe pushtetin lokal.

Në ndihmë të këtyre takimeve ishte edhe ngritja e forumit lokal mjedisor. Forumet lokale Mjedisore janë shumë efikase dhe të gjetura si në realizimin e projektit ashtu dhe në pjesëmarrjen aktive në aktivitete dhe pranë institucioneve vendore, kjo është parë si në takimet nëpër aktivitete ashtu dhe në takimet paraprake pranë institucionet vendore dhe lokale.

Aktore të ndryshme të pushtetit vendor janë njohur me impaktet negative në ZM, dhe kanë shprehur interes për çështjet mjedisore dhe trajtimin e tyre pranë institucioneve përkatëse përgjegjëse.

E megjithatë u vu re që Organizatat e Shoqërisë Civile kanë mekanizma nxites për të mbajtur aktive si nga ana organizative dhe vendimmarrese.



-Nga takimet e bera me pushtetin vendor dhe me gjere jo vetem eshte perkrahur nisma per ngritjen e forumeve locale mjedisore por kerkohet qe keto forume te perfaqesohen jo vetem ne zona te mbrojtura por dhe me gjere.

❖ Aktivitetet e realizuara

Dt. 13 prill 2018

Pjesëmarrja e Org: "Miqësia Ulez" në Tiranë pranë zyratve të INCA-s organizohet takimi i parë i Rrjetit për Ruajtjen e Natyrës në kuadër të fazës së dytë të programit SENiOR=II mbi ecurinë e projektit dhe organizimin e gjithë anetareve të rrjetit për përgaditjen e aktivitetit me rastin e ditës së Tokës 22 prill, në PK Divjake –Karavasta. Qellimi- Bashkëpunimi i Organizatës lider (INCA) dhe shkëmbimi i eksperiencave me të gjithë organizatat e Rrjetit për Ruajtjen e Natyrës mbi ecurinë dhe konkretizimin e aktiviteteve në realizimin dhe zbatimin e programit SENiOR=II.

Dt. 22 Prill 2018

Aktiviteti i Organizatës "Miqësia Ulez" planifikuar dhe realizuar në kuadër të programit SENiOR=II (faza II), në bashkëpunim me INCA-n me rastin e Ditës së Tokës, me temë: Mbjellje e 500 fidaneve pyjore të llojit pishë dhe pastrimi i ambjeteve në PK Divjake –Karavasta.

Qellimi - Aktivitet ndërgjegjësues dhe edukues masiv me rastin e dites se tokes (22 prill)

Dt. 24 Prill 2018

Aktivitet i Organizates "Miqesia Ulez" ne PNR "Liqeni Ulez" planifikuar dhe realizuar ne kuader te programit SENIOR=II (faza II), me teme: "Promovimi i vlerave natyrore ne PNR "Liqeni Ulez" nepermjet festimit te dites se Shen -Markut dhe shpalljes Ulza Eco -Park."



Qellimi - Promovimi i burimeve dhe vlerave natyrore, historike, tradicionale dhe kulturore nepermjet festimit te festes tradicionale te zones (Shen-Markut) ne ZM (PNR "Liqeni Ulez.)

Dt. 03 Maj 2018

Aktivitet i Organizates "Miqesia Ulez" pjese e Rrjetit per Ruajtjen e Natyres ne bashkepunim me rrjetin e organizatave lokale ne PNR "Liqeni Ulez" (OMPeshkimit Ulez dhe OJF P.P.K.Komunal Ulez), dhe ne prani te TV Lokal Mat, dhe prezence te Inspektorit te Peshkimit te Drejtorise Rajonale Diber z. Ervin Ruci dhe inspektorit te Mjedisit ne Bashkine Mat Z. Hysen Dulli per te kryer monitorimin dhe ngritjen e problematikes per impaktet negative mbi situaten e peshkimit, dhe respektimit te kuotes maximale te ujit ne liqenin e Ulzes, ne kohen e riprodhimit biologjik te specieve te peshkut ne kete liqen, nje nga impaktet negative te nxjerra dhe evidentuara gjate fazes se pare te programi SENIOR=II, zbatuara nga REC Shqiperi dhe financuar nga Ambasada Suedeze ne Tirane.

Qellimi - Fuqizimi i rolit veprues dhe advokues te OMSHC-ve te rrjetit lokale ne identifikimin dhe reagimin ndaj ceshtjeve kritike me te cilat perballen liqeni i Ulzes dhe Shlkopetit ne PNR "Liqemi Ulez".

Dt. 07 dhe 11 Maj 2018

Aktivitet me teme: "Mbi procesin e mbjelljes se fidaneve pyjore dhe dekorative ne bashkepunim me strukturat vendore ne kuader te ndërgjegjesimit te komunitetit per te dy zonat e mbrojtura pilot te mara ne studim ne rrethin e Matit, (PNR "Liqeni Ulez" 07 Maj dhe PK Qaf-Shtame)

Qellimi - Te kontribuojme ne ndërgjegjesimin dhe bashkepunimin e te gjithë aktoreve lokal ne menaxhimin dhe mbrojtjen e vlerave natyrore ne zonat e mbrojtura.

Dt. 18 Maj 2018

Aktivitet me teme: "Ngritja e Forumeve Lokale Mjedisore ne Rajonin e Matit dhe te Krujes te gateshme per te marre pjese ne proceset advokuese dhe keshilluese prane strukturave vendore pergjegjese per menaxhimin e burimeve natyrore".

Qellimim - Fuqizimi i rrolit pjesemarrës të OMSHC-ve lokale në promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve të tjera natyrore, në bashkëpunim me aktoret dhe strukturat vendore.

Dt. 08 Qershor 2018

Aktivitet me teme: Takim konsultues dhe ndërgjegjësues/informues për vlerat e natyrës dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, Informimi i tyre mbi gjetjet vlerësimet dhe advokimi mbi rekomandimet për minimizimin e impakteve negative në ZM, PK Qaf-Shatame".

Qellimi - fuqizimi i rrolit pjesemarrës të OMSHC-ve lokale në promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve të tjera natyrore, në bashkëpunim me aktoret dhe strukturat vendore.

Dt. 27 Qershor 2018

Takimi i organizuar nga INCA në bashkëpunim me REC Shqipëri, në prani të përfaqësuesve të ambasades Suedeze në Tiranë dhe gjithë organizatave të rrjetit për ruajtjen e natyrës që u zhvillua në PK Divjake Karavasta me teme: "Pjesëmarrja e komunitetit në advokimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në kuadër të ngritjeve të forumeve lokale".

Qellimi. Rritja dhe forcimi i rolit bashkëpunues të Org të Rrjetit për Ruajtjen e Natyrës në bashkëpunim me REC Shqipëri dhe INCA-n në kuadër të zbatimit dhe realizimit të aktiviteteve të programit SENIOR II.

Dt 28 Qershor 2018

Në sajë të bashkëpunimit të organizatave brenda rrjetit për ruajtjen e natyrës, në ndarjen e përvojës dhe shkëmbimit të eksperiencës ndërmjet tyre merr pjesë në takimin e organizuar nga Org "Pseda Iliria" në PK Dajt pranë zyrave të Njësise Administrative Dajt me teme: Problematikat e evidentuara mjedisore dhe sociale që ka komuniteti i zonës dhe adresimi i zgjidhjes së problemeve në Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit" (aktivitet i realizuar në kuadër të programit SENIOR=II

Qellimi - Forcimi i rolit bashkëpunues dhe shkëmbimi i eksperiencave të përbashkëta ndërmjet Org. të Rrjetit për Ruajtjen e Natyrës në ndarjen e përvojës të realizimit të aktiviteteve të Programit SENIOR II.

Dt. 19 Korrik 2018

Aktiviteti me teme "Problematikat e evidentuara mjedisore dhe sociale që ka komuniteti i zonës dhe adresimi i zgjidhjes së problemeve në PNR "Liqeni Ulez".
Qellimi - arritja dhe fokusimi në përfshirjen më të gjerë të komunitetit, dhe grupeve të interesit në proceset e vendimarrjes që lidhen me këto ZM.

Dt. 07 Gusht 2018

Aktiviteti i realizuar në PK Qaf-Shtame me teme "Problematikat e evidentuara mjedisore dhe sociale që ka komuniteti i zonës dhe adresimi i zgjidhjes së problemeve në PK "Qaf-Shtame".
Qellimi. Arritja dhe fokusimi në përfshirjen më të gjerë të komunitetit, dhe grupeve të interesit në proceset e vendimarrjes që lidhen me këto ZM.

Dt. 25 shtator 2018-10-22

INCA organizoi trajnimin me teme "Aktivitete të ekoturizmit në zonat e mbrojtura përmes promovimit të traditave lokale me bazë natyrën dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore", si dhe u organizua takimi i trete i Rrjetit për Ruajtjen e Natyrës ku u diskutua mbi ecurinë e programit SENIOR=II dhe aktivitetet që do të realizohen në fazën përmblylëse të tijë nga sejcila Org. e rrjetit
Qellimi - Bashkëpunimi dhe përfitimi nga shkëmbimi i eksperiencave të përbashkëta të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Date 28 Shtatore 2018

Aktiviteti në ambientet e keshillit bashkiak Mat me teme "Takim konsultues me bordet e Mjedisit pranë Bashkisë Mat mbi problematikat e evidentuara mjedisore dhe sociale që ka komuniteti i zonës dhe adresimi i zgjidhjes së problemeve në Parkun Natyrorë Rajonal "Liqeni Ulez".
Qellimi - Fuqizimi i rolit pjesëmarrës, advokues dhe vendimarrës i OMSHCE-ve lokale në promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ZM dhe burimeve të tjera natyrore, në bashkëpunim me aktoret dhe strukturat vendore si përgjegjëse në menaxhimin e tyre.

Dt. 28 Shtator 2018

Aktiviteti për realizimin e kronikës televizive në prani të mediave lokale në lidhje me problematikat dhe promovimin e vlerave të PNR "Liqeni Ulez dhe Parkut Kombëtarë "Qaf-Shtame", me rastin e prezantimit dhe përfundimit të projektit SENIOR=II (faza e II) e tijë shih linkun <https://youtu.be/RgoJK5S3so8>

Qellimi - Promovimi i ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve natyrore për të dy zonat pilot të marra në studim PK "Qaf-Shtame" dhe PNR "Liqeni Ulez", të vlerave dhe problematikave që ato kanë.

Date 06 dhe 27 Shtator

Organizata "Miqesia Ulez" në bashkëpunim me përfaqësues të federatës së sportit të Raftingut në Shqipëri, organizuan në Luginen e Liqenit të Shkopetit ushtrimin e këtij sporti si dhe promovimin e vlerave natyrore dhe aplikimin e modeleve ekoturistike dhe tradicionale të zonës.

Qellimi - Ofrimi i modeleve ekoturistike përmes promovimit të traditave lokale me bazë natyren dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në ZM.

❖ Arritjet dhe produktet e projektit.

- Adresim profesional i problematikave kryesore me të cilat përballen sot dy ZM pilot të marra në studim PK "Qaf-Shtame" dhe PNR "Liqeni Ulez", të mbrojtura me ligje si dhe rekomandimet përkatëse për minimizimin e tyre.
- Nxitja e grupimeve të OMSHC rajonale (Mat) dhe (Krujë) të afta dhe aktive në identifikimin dhe reagimin ndaj problematikave me të cilat përballen sot ZM.
- Arritja e promovimit me rastin e ditë festave tradicionale të vlerave të PNR "Liqeni i Ulzes" nëpërmjet bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe aktore të ndryshme të komunitetit lokal të zonës.
- Rritja e bashkëpunimit me AdRZM dhe pushtetin lokal për përfshirjen dhe marrjen në konsideratë të zërimit të shoqërisë civile në vendimmarrjet lokale mbi menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura.
- Ngritja e një forumi lokal mjedisor për të dy ZM pilot të marra në studim e afte për të advokuar dhe lobuar pranë strukturave lokale dhe qendrore, si përgjegjëse kryesore në menaxhimin e burimeve dhe vlerave natyrore.
- Adresimin e pengesave dhe mangesive në përfshirjen efektive të shoqërisë civile dhe komunitetit lokal në proceset lokale vendim-marrjes në dy ZM të rajonit Mat dhe Krujë.
- Pjesëmarrje me e gjere e përfaqësuesve të komuniteteve lokale, lidhur me reagimin dhe advokimin për minimizimin e problematikave dhe menaxhimin e burimeve natyrore (bordet mjedisore, bashki keshille/bashkiak).
- Numer në rritje i prononcimeve dhe vemendjes mediatike drejt qeshtjeve të nxehtane fushen e ruajtjes së natyres.
- Identifikimi, advokimi dhe lobimi i problematikave me in-pakt neativ, sic eshte rasti i ruajtjes së nivelit maksimal të ujërave në liqenin e Ulez dhe Shkopet gjatë sezonit të shtimit biologjik të peshkut gjatë muajt Maj- Qershor, takimin i realizuar nga Org: "Miqesia Ulez" me Org: lokale, OMPeshkimit dhe OJF Përdoruesve të Pyjeve Komunal dhe me pjesëmarrjen të përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe qendrore, dhe aktore të tjera lokale, në prani të tv Mat dhe Vizion Plus, ku është hartuar një kronikë

televizive ne edicionin qendrore te lajmeve ne TV Mat dhe TV Vizion plus, per kete problematike mjedisore qe shkakton impakt negativ ne kete liqen,

- Shoqeria civile dhe aktoret e tjere ne komunitet jane me te interesuar apo te ndergjegjesuar ndaj trajtimeve te problematikave me impakt negativ ne ZM, se vete institucionet pergjegjese shtetere si ato te pushtetit vendore apo qendrore madje ky reagim dhe interesim po vihet re ne rritje nga takimi ne takim qe neve kemi realizuar nga aktivitetet e progameve SENiOR=II dhe me pare.

- Krijimi dhe rivitalizimi me lloje te ndryshme pyjore te kopshtit Dentrobotanik (sip 5.5 dylm) tek zyrat e PNR "Liqeni Ulez".

- Perfshirja ne aktivitete te perbashketa dhe takimet me tema mjedisore(ore mjedisore), dhe festimi i diteve te shenuara mjedisore kombetare dhe nderkombetare me nxenesit e shkolles 9-vecare Ulez dhe grupmoshat e ndryshme te femijeve si kopshte, shkollat fillore, 9-vjeqare te ardhura nga Burreli.

❖ Organizata "Flag Pine"



Menaxhimi i zonave të mbrojtura mjedisore në vendin tonë vazhdon të vuajë pasojat e një moskoordinimi të mirë të institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal. Mbi të gjitha këto pasoja ndihen në komunitetet lokale dhe grupet e interesit, të cilët nuk janë të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë dhe përfitimet e tyre nga funksionimi me efektivitet i menaxhimit të zonës. Pavarësisht përcaktimit në legjislacion, institucionet vendore

pranojnë se niveli i informimit për çështjet mjedisore është shumë i ulët në nivel kombëtar, por kjo është edhe më e theksuar në nivel lokal, ku popullësia lokale shprehet se pothuaj anashkalohet nga institucionet sa hërë që diskutohet mbi shprehjen e opinionit për vendimet që ndikojnë në mjedis

Për të adresuar këto problematika është e nevojshme ndërhyrja e organizatave të shoqërisë civile, të cilat do të shërbenin si katalizatori në mardhëniet midis komunitetit dhe institucioneve shtetërore në zbatim të ligjit për mbrojtien e mjedisit dhe zonave të mbrojtura.

Ngritja e forumit Lokal Mjedisor, do të shërbej si një urë lidhese midis banorëve të këtyre zonave dhe Advokimit të problematikave deri në instancat me të larta vendore dhe Qendrore.

Proceset e konsultimit me publikun duhet të zhvillohen si debate publike dhe të hapura dhe transparente lidhur me projektet e mëdha që ndikojnë drejtpërdrejtë në vijueshmërinë e mjedisit dhe të zonës së mbrojtur.



Aktiviteti 1, date 18.03.2018

Perfshin ngritjen e stafit të projektit dat 18 Mars në qytetin Vlorë përbër nga 3 persona. Saimir Brahim, Nexhip Hysolako, Tatiana Mëhillaj. Grupi ka qënë përgjegjës specifikisht për koordinimin e projektit, krijimin e forumit, zhvillimin e tre takimeve, realizimi i sondazheve me grupet e interesit dhe komunitetin mbi vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes dhe informimit në proceset vendimmarrëse...

Aktiviteti 2, date 18.04.2018

Është zhvilluar në dat 18 Prill në PK Llogara si një nga përfituesit kryesor në zhvillimin e këtij projekti kryesisht lidhur me promovimin e aktiviteteve në natyrë me fokus shtigjet mjedisore. Arsyeja e dytë pse u zgjodh kjo zonë është afërsia që ka me dy zona të tjera të projektit të cilat janë Parku Natyror Karaburun dhe Parku Detar Kombëtar Karaburun Sazan. Të tre këto zona administrohen dhe menaxhohen nga Administrata rajonale e Zonave të mbrojtura. Pjemarrës 30 persona.

Aktiviteti 3, date 22.04.2018

I zhvilluar në Parkun Kombëtar Divjakë Karavasta, 22 Prilli Dita Ndërkombëtare e Tokës. Me koordinimin e rrjetit, drejtuar nga INCA, u zhvillua pjesëmarrja në realizimin e aktivitetit ndërgjegjësues dhe edukues në Parkun Kombëtar të Divjakë-Karavastësë. Në këtë festë shoqata Flag Pine kontribuojë me sigurimin dhe mbjelljen e 500 fidanëve Pishë e Butë në parkun e Karavastase,...

Aktiviteti 4, date 28.04.2018

Në PM Vjos – Nartë, dat 28 Prill. Shkolla e Mesme "Qemal Ataturku. Studentët u shoqëruan në zonën e mbrojtur PM Vjosë Nartë për të zhvilluar një orë të hapur mësimore mbi rëndësinë e lagunave dhe zonave të mbrojtura si dhe patën mundësinë të vëzhgojnë shpendët në lagunë. Aktiviteti u përmbyll me mbjelljen e 400 fidanëve të pishës në pyllin e Hidrovorit.

Aktiviteti 5, date 07.05.2018

Prezantim i vlerave PKD Karaburun Sazanë QV Radhimë. Prezantimi në bashkëpunim me AdZM Vlorë i vlerave të PKD, qendrës së Rehabilitimit të Breshkave dhe rëndësisë së ruajtjes së habitateve dhe promovimit të sjelljes së përgjegjësme në zonë. Aktiviteti u zhvillua me nxënësit e shkollës 9 vjecare Balil Pelari Orikum. Pjesëmarrës në aktivitet 20 nxënës.

Aktiviteti 6, date 10/05/2018



Aktivitet ndërgjegjësimi dhe pastrim në PK Llogara me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës "Hasan Mëhilli" Dukat I Ri, ku së bashku me punjës të ADZM Vlorë, puntorët e shërbimeve të Njesisë Administrative Orikum, u realizua një pastrim i mbeturinave të shpërndara në PK Llogara. Gjithashtu u bë edhe diferencimi i mbetjeve të ndara në qeska të veçanta ,plastik ,qelqe dhe mbetje të ndryshme.. Pjesëmarrës në aktivitet rreth 35 persona.

Aktiviteti 7, date 17.05.2018

Prezantimi i procesit të krijimit të qendrës së vizitorëve Llogara, me nxënës të shkollës "Hasan Mëhilli" Dukat i Ri. Nxënës u njohën nga me procesin e krijimit të qendrës së vizitorëve Llogara, në bashkëpunim me AdZM Vlorë. Qëllimi, promovimi i aktiviteteve turistike në natyrë, po kështu u bë edhe shoqërimi i nxënësve të shkollës në një nga shtigjet mjedisore. Pjesëmarrës 23 nxënës.

Aktiviteti 8, date 22.05.2018

Prezantimi vleravete PKD Karaburun Sazan në QV Radhimë me nxënës të shkollës së mesme "Hasan Pulo" Orikum. Prezantimi në bashkëpunim me AdZM Vlorë i vleravetë PKD, qendrës së Rehabilitimit të Breshkave dhe rëndësisë së ruajtjes së habitateve .Po kështu nxënësve ju bë edhe një prezantim në terren i menyrës së peshkimit artizanal nga peshkatar te Radhimës.

Aktiviteti 9, date 24.05.2018

U realizua ngritja e një forumi lokal mjedisor në rrethin Vlorë me përfaqësues nga NGO lokale, ekspert lokal dhe operatorë lokal, icili do të shërbejë si një strukturë lokale profesionale e gatshme për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore. Forumi miratoi një kalendar të punimeve për periudhë 2 vjeçare. Kryetar i forumit u zgjodh me konsensus të plotë z.Hamza Kuteli dhe sekretar z. Almarin Xhakaj.

Aktiviteti 10, date 05.06.2018

Në kuadër të ditës botërorë të mjedisit, forumi lokal mjedisor i krijuar në dat 25.06.2018, zhvilloi një orë mjedisore me shkollën 9-vjecare Balil Pelari, Orikum. Aktiviteti u drejtua nga kryetari I këtij forumi z. Hamza Kuteli, ku nëpërmjet matrialeve të prezantuara i njohu nxënësit e kesaj shkolle me vlerat e rrala mjedisore që ndodhen ne krahinën tonë, për të nxitur tek ky brez ndjenjën e përkujdesjes dhe mbrojtjes së natyrës.

Aktiviteti 11, date 09.06.2018

Takim i zhvilluar në kuadër të prezantimit dhe promovimit të aktiviteteve në natyrë në Parkun Kombëtar Llogara dhe PM Vjosë- Nartë. Po kështu pjemarrje në këtë aktivitete ishin edhe ADZM-Vlore, Njësia Administrative Orikum dhe grupe te interesit. Nga kordinatori i projektit u bë një prezantim i zhvillimive të aktiviteteve të projektit gjatë kësaj periudhe. Në pjesën e dytë të aktivitetit nga eksperti i shtigjeve mjedisore, z nexhip Hysolakoj bëri një prezantim të punës në terren. Për personat që kryejnë shërbimin e guidave turistike u zhvillua një trajnimi i 20 guidave mbi menyrën e komunikimit me vizitorët dhe njohja me vlerat ekologjike dhe historike të zonës ku operojnë.

Aktiviteti 12, periudha 15 Maj - 30 Qershor

Është bërë identifikimii i shtigjeve tokësore në PK Llogara, RNM Karaburun dhe PM Vjosë Nartë. Ky aktivitet përfundoi me përcaktimin e 14 shtigjeve të këmbësorëve në tre ZM. Nga ky indetifikim në terren i shtigjeve eksperti i kontraktuar nga Shoqata z. Nexhi Hysolakoj, hartoi një matrial studimor mbi këta shtigje me të dhënat kryesore, kordinatat dhe atraksionet . Mbi bazën e këtij studimi është bërë edhe dizenjimi i broshurës së shtigjeve mjedisore.



Aktiviteti 13, date 15.07.2018

Botim i dy artikujve mjedisore. Promovimi i ruajtjes së burimeve natyrore në zonat e mbrojtura në gjirin e Vlorës dhe vlerave dhe problematikave që ato kanë nëpërmjet realizimitme 2 shkrime tek Mjedisi sot. Promovimi i tyre ne rrjetet sociale te shoqatës.

Aktiviteti 14, periudha Gusht - 20 Shtator.

Gjate muajit Gushtë është përmbyllur faza e realizimi i filmimeve në Zonat e Mbrojtura të Vlorës që janë përfshirë në projekt. Qëllimi i këtij dokumentari promovimi sa me i gjere i bukurive panoramike në ZM të këtij projekti dhe ndërgjesimi i banorëve vendas për të ruajtur dhe kujdesur mjedisin dhe abitatet, si mundësi ekonomike për banorët e atyre zonave.

Aktiviteti 15, 1 Maj 20 Shtator

Përfundimi i sondazheve dhe takimeve me aktorët lokalë, drejtuesit e Institucioneve në Rrethin e Vlorës që kanë lidhje të punës së tyre mjedisin dhe problemet mjedisore. Nga Eksperti I kontraktuar znj. Tatjana Mëhillaj, u realizua një raport, ku janë përfshirë të dhëna mbi vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë, që influencojnë mjedisin dhe në vecanti zonat e mbrojtura, ku janë vëzhguar nga afër disa mbledhje të Këshillit Bashkiak.

Aktiviteti 17, 15 Shtator

Me përfundimin e markimit të shtigjeve dhe hartimit të raporti nga eksperti i shtigjeve, u botua një hartë me broshurë e cila ka informacione mbi vlerat e vecanta që turistët do të gjejnë gjat rrugëtimit në këto shtigje. Qëllimi kryesor promovimi i turizmit në natyrë nëpërmjet aktiviteteve Eko-Turistike.

Aktiviteti 18, date 22.09.2018

Promovim në Televizionin "REAL Rtv", dokumentarit filmik realizuar në atraksionet më të bukura të ZM që janë përfshirë në projekt. Intervista në televizion ka zgjatur rreth 20 min, ku pjesë e emisionit ishte edhe publikimi për her të parë i dokumentarit. Pjesë e bashkëpunimit në emision me gazetaren Jerola Ziaj, ishte fokusi i këtij projekti, problematikat që janë hasur dhe situata e mjedisit dhe advokimit për ZM, në përgjithësi.

Aktiviteti 19, date 27.09.2018.

Me rastin e ditës Ndërkombtare të Turizmit në Qendrën e Vizitorëve Radhime, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 12-vjeçare, "Hasan Mëhilli" Dukat. Nxënësit u njohën nga afër me vlerat e PK Detar Sazan- Karaburun, për të promovuar turizmin e qëndrueshëm në Zonat e Mbrojtura të Vlorës.

Takimi përmblyës i projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Zonat e Mbrojtura në Gjirin e Vlorës". Ku bëhet prezantimi i aritjeve të projektit dhe veçoritë që solli ky projekt për komunitetet e ZM, duke paraqitur gjithashtu metodologjitë me efikasë të përfshirjes së publikut në vendimarrje.

- ❖ **Produkte konkrete të këtij projekti;**
- ✓ Pisha të mbjella 1000 fidan. Në PK Divjak 500 dhe 500 copë në PM Vjos-Nartë.
- ✓ Ngritja e Forumi Lokal Mjediore, funksionon me rregullore dhe statut me vete, drejtues Hamza Kuteli, sekretar Almarin Xhakaj. Vepron me kalendar aktivitetesh në komunitet për advokimin e çështjeve mjedisore.
- ✓ 1 Raport studimor mbi shtigjet mjedisore në Zonat e Mbrojtura.
- ✓ 500 cop Broshura për shtigjet mjedisore më atraktive në ZM të Projektit.
- ✓ 20 guida lokale të trajnuara për sjelljen e turistit në park dhe modelin e guidës në shtigje.
- ✓ 2 artikuj mjedisor në revistën Mjedisi Sot.
- ✓ 1 Raport studimor me sondazhe mbi vendimarrjen dhe informimin e publikut
- ✓ 1 Dokumentar televiziv për promovimin e veçorive të ZM në gjirin e Vlorës.

❖ **Organizata "Çajupi"**



Projekti SENIOR II Faza e II pati si Objektiv të përgjithshëm "Të kontribojë në menaxhimin e qëndrueshëm të ZM nëpërmjet forcimit të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile" dhe si Objektiv Specifik: i) Fuqizimin e rolit veprues të OMSHC në menaxhim dhe reagimin ndaj çështjeve kritike me të cilat përballen ZM. Ii) Organizimi i Forumit të Parkut "Bredhi i Hotoves-Dangelli si faktor i rëndësishëm i rolit pjesëmarrës të komunitetit vendor në vendimarrje ashtu edhe në ndarjen të përfitimeve në menaxhimin e qëndrueshëm të ZM.

Jane arritur objektivi përgjithshëm dhe ato specifik duke punuar në dy drejtime kryesore:

Krijimi i Forumit Lokal Mjedisor për Zonat e Mbrojtura (ZM) në Qarkun Gjirokastrë i afte për të përfshirë aktivisht në proceset e monitorimit të aktiviteteve që do zhvillohen në to.

Pjesëmarrje e mire e shoqërisë civile dhe komunitetit lokal ne promovimin dhe bashkëpunimin ne menaxhimin e përbashkët te burimeve natyrore ne rajonin e Gjirokastrës ne fokus Zonat e Mbrojtura ne kete qark.

Ne Projektin SENiOR II, Faza e II janë realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara. Ne projekt janë përfshirë banorë të zonave ku është zhvilluar projekti, nxënës të shkollave, institucione vendore, AdZM Qarku Gjirokastrë, Inspektoriati I Mjedisit etj. Janë përfshirë kanë kontribuar me pjesëmarrje ne mbjelljeve te fidanave pyjor banore vendor, OJF vendore, nënës te shkollave 9 vjecare ne Permet e Dropull. Një ndihmese të vacante në arritjen e objektivave kanë dhënë edhe Institucionet Vendore si: AdZM-Gjirokastrë, DAR Gjirokastrë, Bashkive Permet e Dropull dhe NJA Petran, Piskove, Dropulli i Siperem. Ndone se te pa specifikura ne projekt si aktore pjesemarrjes, u bashkepunua dhe me Seksionet (sektoret) e pyjeve te Bashkive Permet, Dropull, Kelcyre e Tepelene, Shoqata per investime ne Pyje Petran, Shoqata e Pyjeve Dropull, etj.

- ❖ Si arrijtet me kryesore nga zbatimi i projektit vecojme:
- ✓ Ngritja e Formit Lokal Mjedisor per Administrimin e Zonave te Mbrojtura dhe te burimeve tjera natyrore ne nivel Qarku, me funksion kryesor; pjesemarrje aktive ne proceset e monitorimit dhe vendimarrjes per Zonat e Mbrojtura dhe jo vetem ne nivel qarku.
- ✓ Veprimtari permiresuese te mjediseve ne Zonat e Mbrojtura, edukim i nxeneseve me pjesemrrje direkte te tyre ne mbjelljen e 500 fidanave pyjor ne PK Divjake-Karavasta dhe 500 fidanave pyjore PK Bredhi Hotoves-Dangelli. Per keta te fundit vazhdon perkujdesja dhe sherbimet ndaj tyre deri ne mbyllje te projektit.
- ✓ Njohje dhe promovimi i zonave te mbrojtura te përfshira ne projekt duke organizuar udhetime me nxenes dhe mesues ne Sotire dhe Hotove. Pergatitja e nje dokumentari informativo promovues rreth 30 minuta per dy ZM: "Dy bredhishtet ne Jugun e Shqiperise". Per Bredhin e Sotires si nje shtegtim i ri turistik mjaft i pelqyer (i cili u be i njohur se shumti nga projekti "Seniora A" me fp) tashme (separi) ka nje "Udhezues ekoturistik (Guide) te plote ne sherbim te vizitoreve. Kjo eshte shtypur dhe shperndare ne palet e interesura.



❖ Produkte të projektit

- ✓ U mbollen 1000 fidana pyjore në: PK "Bredhi i Hotoves Dangelli" dhe ZM" Divjake Kravasta".

- ✓ Ngritja e Forumi Lokal Mjediore i cili funksionon me program e rregullore dhe

MIRË SE ERDHËT NË SOTIRË; E NJIHENI DHE VIZITONI ATË!



statut me vete, drejtues Z.Vangjel Sotiri dhe sekretar Z Bledar Vangjeli. Ky Forum vepron me kalendar aktivitetelesh në komunitet për advokimin e çështjeve mjedisore.

- ✓ U pergatiten dhe u printuan 300 harta e Udherrefyemit turistik (guide) per Bredhin e Sotires "SOTIRA,SHTEGTIM TURISTIK DREJT TË PANJOHURËS". Kendi i informimit ne fshat.

- ✓ Dokumentar televiziv për promovimin e burimeve dhe vlerave natyrore në të dy ZM, PK "Bredhi i Hotoves Dangelli" dhe ZM" Bredhi i

Sotires". Njohja me e plote dhe Promovimi qe ne fazen e pare te projektit SENIORA II dhe me shume ne fazen e dyte e MN Bredhit te Sotires kane cuar ne rritje te ndjeshme te vizitoreve ne ate Monument natyre. Nuk ka nje numur te sakte por nga sa eshte vezhguar nga pushtetit vendor kjo rritje vleresohet ne 30-50%

- ✓ Si nje "produkt" shume te rëndesishem qe lidhet me dy fazat e ketij projektit SENIORA II ne dy zonat e mbrojtura ku u zbatua eshte mungesa e demtimeve nga zjarret ne kete vit. Pra takimet informimi dhe vete pjesemarrja e banoreve vendor ne projekt duhet vleresur se pari me kete arritje qe nuk eshte vetem e projektit por ai ka ndikuar fuqishem ne kete drejtim.

- ✓ Te gjitha realizimet si me siper jane materializuar me foto dhe postime ne rrjetin Social Fb te Shoqates Mjedisore Cajupi dhe te publikura dhe ne faqen Senioralbania dhe [Embassy of Sweden in Tirana](#) # [Senior Albania](#). Jane dhene tre kronika ne TVGJ dhe VOA

❖ Vazhdimesia;

- ✓ Nevoja për një mbështetje në forcim kapacitetesh në një periudhë afatshkurter të Forumit Lokal Mjedisor (i sapo krijuar) për menaxhimin e Parkut.
- ✓ Të mundesohen që në vite qofte dhe në sipërfaqe të vogla të behen mbjellje fidanash sipas modelit që u krijua.
- ✓ Nevoja për ngritje kapacitetesh për mbrojtjen nga zjarret në dy zonat e projektit dhe jo vetëm.
- ✓ Përdorimi i festave lokale si një ditë ku mund të njihen dhe promovohen me shumë zonat e mbrojtura. Promovim me i madh në nivel kombëtar i ZM të rajonit Jugor të vendit. Promovim për dy brezhishtët e Hotoves dhe Sotires që janë të bukura dhe të arritshme gjatë gjithë vitit.

❖ Organizata "Green and Clean"

Zonat e Mbrojtura vazhdojnë të mos menaxhohen mirë nga institucionet lokale dhe kombëtare. Vetë institucionet lokale dhe ato vendore nga pyetesorët e bërë pranojnë se niveli i informimit dhe i vendimmarrjes për çështjet mjedisore nga ana e publikut është i ulët.



Për të krijuar një bashkëpunim sa më të afërt midis strukturave përkatëse për mbrojtjen e mjedisit dhe përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes për

çështjet mjedisore është e nevojshme nderhyrja e organizatave të shoqërisë civile.

Krijimi i forumit Lokal Mjedisor do të shërbejë si urë lidhëse midis banorëve të këtyre zonave dhe institucioneve për përfshirje sa më të gjerë të publikut në procesin e vendimmarrjes.



Aktivitet Nr. 1. Në bashkëpunim me Rrjetin për Mbrojtjen e Natyrës realizimin e aktivitetit ndërgjegjësues dhe edukues me rastin e Ditës së Tokës.



Vendi: Parku Kombëtar Divjakë Karavasta Qellimi: Aktivitet ndërgjegjësues dhe edukues me rastin e Ditës së Tokës

Arritjet/Produktet: Mbjellja e 500 fidanave pishë e zezë, pastrimi i një sipërfaqeje në plazhin e Divjakës nga mbetjet plastike dhe transportimi pranë pikave të grumbullimit.

Aktivitet Nr.2 Në bashkëpunim me AdZN Korçë organizara Green and Clean organizoi realizimin e aktivitetit ndërgjegjësues
Vendi: Parku Kombëtar Bredhi I Drenovës
Qellimi: Aktivitet gjelberimi dhe pasrimi.
Arritjet/Produktet: Mjellja e 500 fidananëve brend në sipërfaqen e djegur si dhe pastirim i sipërfaqes në Parkun Kombëtar Bredhi i Drenovës



Aktivitet Nr.3 Organizimi i një aktiviteti informues dhe ndërgjegjësues në ditën e Shën Kostandinit në Parkun Kombëtar Bredhi i Drenovës Festa e Shën Kostandinit
Vendi: Parku Kombëtar Bredhi I Drenovës
Qellimi: Ky aktivitet kishte në fokus ndërgjegjësimin për përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore dhe përfshirja e aktoreve lokal në menaxhimin e P.K Bredhi i Drenovës
Arritjet/Produktet: Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të Parkut Komëtar Bredhi i Drenovës, 200 cop broshura për promovimin e vlerave të këtij Parku Kombëtar.

Aktivitet Nr.4 Në Ditën Botërore të Mjdisit në bashkëpunim me CNVP dhe AdZM organizuam aktivitet ndërgjegjësues dhe edukues në Parkun Kombëtar Prespa
Vendi: Parkun Kombëtar Prespë
Qellimi: Aktivitet ndërgjegjësues dhe edukues
Arritjet/Produktet: Njohja e vlerave të Parkut Kombëtar Prespë nga nxenesit e shkollës Vithkuq ,Bashkia Korçë

Aktivitet Nr.5 Organizimi i një orë mesimore edukuese mbi burimet natyrore dhe problematikat e Parkut Kombëtar Prespa në shkollën e Pustecit
Vendi: Parkun Kombëtar Prespë
Qellimi: Aktivitet ndërgjegjësues dhe edukues
Arritjet/Produktet: Njohja e vlerave dhe problematikave të Parkut Kombëtar Prespë nga nxenesit e shkollës Pustec

Aktivitet Nr.6 Organizimi i disa takimeve konsultive dhe ndërgjegjësuese / informuese me AdZM. Inspektoratin e Mjedisit, Bashkive dhe Njësi Administrative si dhe grupeve të interesit, komuniteti lokal , biznesi privat dhe të autoriteteve vendore , në dy Parqet : Parku Kombëtar Prespa dhe Parku Kombëtar Bredhi i Drenovës
Vendi: Parkun Kombëtar Prespë
Qellimi: Aktivitet ndërgjegjësues dhe informues.

Arritjet/Produktet: Informimi mbi gjëndjen , vleresimet dhe rekomandimet per minimizimin e inpakteve negative ne dy Parqet te Qarkut Korçë , Parku Kombëtar Prespa dhe Bredhi i Drenovës.

Aktivitet Nr.7 Krijimi i Forumit Mjedisor ne qarkun e Korces për të dy parqet Parkun Kombëtar Prespa dhe Parkun Kombëtar Bredhi i Drenovës

Vendi: Parkun Kombëtar Prespë

Qellimi: Krijimi i Forumit Mjedisor

Arritjet/Produktet: Krijimi i Forumit Mjedisor në qarkun e Korcës i cili do të shërbejë si një strukturë lokale profesionale e gatshme për te marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore.

Aktivitet Nr.8 Realizimi i një dokumentari (spoti) ne te dy ZM atë te Prsepës dhe B.Drenovës.

Vendi: Parku Kombëtar Prsepës dhe B.Drenovës

Qellimi: Realizimi i një dokumentari (spoti) P.K Prespa dhe P.K Bredhi i Drenovës

Arritjet/Produktet: Promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të të dyja Zonave të Mbrojtura, Parkut Kombëtar Prespa dhe Parkut Kombëtar Bredhi i Drenovës

❖ Arritjet / produktet

- ✓ Mbjellja e 500 fidananëve pishë e zezë, pastrami i një sipërfaqeje në plazhin e Divjakës nga mbetjet plastike dhe transportimi pranë pikave të grumbullimit.
- ✓ Mjellja e 500 fidananëve bredh në sipërfaqen e djegur si dhe pastirim i sipërfaqes ne Parkun Kombëtar Bredhi i Drenovës
- ✓ Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të Parkut Komëtar Bredhi i Drenovës
- ✓ 200 cop broshura për promovimin e vlerave të ParkuT Kombëtar Bredhi i Drenovës.
- ✓ Njohja e vlerave të Parkut Kombëtar Prespë nga nxenesit e shkollës Vithkuq ,Bashkia Korçë
- ✓ Njohja e vlerave dhe problematikave të Parkut Kombëtar Prespë nga nxenesit e shkollës Pustec
- ✓ Informimi mbi gjëndjen , vleresimet dhe rekomandimet per minimizimin e inpakteve negative ne dy Parqet te Qarkut Korçë , Parku Kombëtar Prespa dhe Bredhi i Drenovës
- ✓ Krijimi i Forumit Mjedisor në qarkun e Korcës i cili do të shërbejë si një strukturë lokale profesionale e gatshme për te marrë pjesë në proceset

advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore.

- ✓ Promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të të dyja Zonave të Mbrojtura, Parkut Kombëtar Prespa dhe Parkut Kombëtar Bredhi i Drenovës.

❖ **Organizata: Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit**



Gjatë periudhës të zbatimit të projektit 15 Mars - 15 Tetor 2018 "Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Zonat e Mbrojtura "(Faza II), në Parku Natyror "Korab-Koritnik" dhe Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës", ku gjatë zbatimit të projektit janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, ku kemi synuar: Të inkurajojmë bashkëpunimin ndërmjet OMSHC-ve, autoritetet publike,

komunitetet lokale, biznesin dhe mediave dhe të nxisë rrjetëzimin dhe ndërtimin e partneritetit mes tyre në fushën e mbrojtjes së natyrës në dy ZM (Parku Natyror "Korab-Koritnik" dhe Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës"), si dhe kemi bërë të mundur të fuqizojmë rolin pjesëmarrës të OMSHC-ve lokale në promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve të tjera natyrore, në bashkëpunim me aktoret dhe strukturat vendore.

Një pikë e fortë e këtij projekti ka qënë advokimi i komunitetit të zonave ku është zbatuar projekti, të rinjëve dhe nxënësve të shkollave. Janë përfshirë në aktivitetet rreth 160 banor, kanë ndihmuar në aktivitetet rreth 250 nxënës nga shkollat e mesme "Havzi Nela", Kukës, shkolla e mesme "E bashkuar", Bajram Curr si dhe shkolla e mesme në Shishtavec, Topojan.

Një pjesëmarrje e madhe e shumë të rinjëve aktive me pasion mjedisin na ka ndihmuar neve si shoqatë por gjithashtu ka rritur dëshirën për të punuar më shumë mbi mjedisin dhe kemi vënë re ndërgjegjësimin e banorëve për kujdesin e mjedisit, biodiversitetin dhe vlerat natyrore që përfaqesojnë.



Sukese i këtij projekti ka qënë edhe aktivizimi dhe përfshirja e publikut në aktivitetet në dy ZM si dhe ngritja e zërit në mbledhjet e këshillave bashkiake në Bashki: Kukës dhe Bashkinë Trojçe, për zgjidhjen e problemeve që ndikojnë në mjedisin sidomos për parandalimin e ndërtimeve të HEC-ve në 2 MZ. Një përkrahje të vërtetë dhe të madhe në arritjen e objektivit dhe qëllimit të këtij projekti kanë dhënë edhe Institucionet me të cilat kemi pasur bashkëpunime, në veçanti AdRZM-Kukës, Njësitë Administrative brenda zonave të mbrojtura, shoqatat partnere, këshilli

bashkiak i Bashkise Kukes dhe Bashkise Bajram Curr, komuniteti i zones dhe institucionet e tjera perkatese ne fushen e mjedisit.

Bashkëpunimi me palët e interes të larte permendura është një nga objektivat strategjike të cdo shoqate OJF, gjithashtu edhe e jona, si parakusht për zhvillim cilësor të rezultateve tona dhe të rris njohuritë e palëve të interesit, për të kuptuar rolin dhe përgjegjësitë që mbart mbrojtja e mjedisit, promovimi i vlerave dhe burimeve natyrore që ato perfaqesojne.

Në bashkëpunimin tonë me institucionet e nivelit qendror dhe atij local, kemi pasur një qasje të integruar e cila siguron një pamje mbi faktet dhe një perspektivë të fokusuar në përmirësimin e qeverisjes së mirë, dizajnin e sistemit, implementimin e procesit dhe masave korigjuese. Rekomandime të qarta dhe koncize në raportet tona të projektit janë elemente kyçe për këtë.

❖ Aktivitetet e realizuara

Me 20.03.2018, ne kuader te projektit "Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore ne ZM", shoqata "Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit" organizoj aktivitetet ndergjegjesues ne prage te dites nderkombetare te pyjeve (22 Marsit) ku u mbollen 500 fidane pyjor ne pjese e Parkut Natyror Korab-Koritnik, (ne zonen Belaj dhe ne shkollen 9-vjeçare Gosti) ne kete proces moren pjese punonjes te AdZM Kukes, nxenes dhe mesues te shkollës 9-vjeçare Gosti dhe banore te zones

Me date 22 Prill ne Parkun Kombetar "Divjake-Karavasta", ne bashkepunim me INCA dhe me organizatat e tjera mjedisore qe jane pjese e rrjetit te Mbrojtjes se Natyres ne te gjithë Shqipërinë, u organizua nje aktivitet ndergjegjesues dhe edukues me rastin e Dites se Tokes (22 Prill). Shoqata jone kontriboi me sigurimin e 500 fidaneve Pise e Bute per mbjellje ne parkun e Karavastase.

Me Datë 27.06.2018, në kuadër të projektit nga drejtuesit e Rrjetit Për Mbrojtjen e Natyrës, REC-Shqipëri dhe INCA, në Qendrën e Vizitorëve PK Divjak-Karavasta, organizuan bashkëbisedimin me grupet e interesit mbi modelet e advokimit për një vendimarrje dhe një manaxhim të qëndrueshëm të ZMM. Për të arritur nxitjen e krijimit dhe të funksionimit të forumeve lokale mjedisore. Ky takim kishte si qëllim kryesor të promovojë arritjet dhe sfidat e Rrjetit Për Mbrojtjen e Natyrës ku së bashku me grupet e interesit të bëjë një përjasje për proceset e advokimit, nëpërmjet përfaqësimit të aktorëve në një struktur të përbashkët forum lokal, pran strukturave vendore që janë përgjegjëse për Zonat e Mbrojtura.



Ky takim kishte si qëllim kryesor të promovojë arritjet dhe sfidat e Rrjetit Për Mbrojtjen e Natyrës ku së bashku me grupet e interesit të bëjë një përjasje për proceset e advokimit, nëpërmjet përfaqësimit të aktorëve në një struktur të përbashkët forum lokal, pran strukturave vendore që janë përgjegjëse për Zonat e Mbrojtura.

13.08.2018 Kemi organizuar bashkëbisedimin me grupet e interesit për "Nxitja e krijimit dhe të funksionimit të

forumeve lokale mjedisore" për finalizimin e ngritjes së Forumit LokalPN. Qëllimi i takimit ishte të konsultojë dhe identifikojë, në bashkëpunim me grupet e interesit në nivel lokal, përfaqshen më të mirë të përfshirjes së tyre në proceset e advokimit dhe mirëmenaxhimit të parkut kombëtar, nëpërmjet përfaqësimit të aktorëve kryesor lokal në një strukturë të përbashkët - Forumi Lokal, pranë strukturave vendore përgjegjëse në Parkun Kombëtar "Lugina e Valbonës" dhe në Parku Natyror "Korab-Koritnik".

(MMZHT) në kuader të projektit ka zbatuar modelin e strukturës dhe mënyrën e funksionimit të këtij forumi bashkë me stafin e Bashkisë dhe Administratën e Parkut Kombëtar dhe Parkut Natyrore, të propozuar nga INCA. Gjithashtu, (MMZHT) do të synojë informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të forumit mbi problematikat e verejtura (gjatë fazës së I-rë të projektit) dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre, bazuar në legjislationin e fuqi.

Janë bërë takime informuese-konsultuese për finalizimin e ngritjes së Forumit Lokal Parku Natyror "Korab-Koritnik", me aktorët e interesit të evidentuar në takimet e mëparshme.

U realizua ngritja e Forumi lokal mjedisor për Parkun Kombëtar "Lugina e Valbonës" me përfaqësues nga NGO lokale, ekspert lokal dhe operatorë lokal, i cili do të shërbejë si një strukturë lokale profesionale e gatshme për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore.

Në bashkëpunimi me drejtuesit e projektit dhe forumi tashme të ngritur është hartuar dhe miratuar Kalendarin e angazhimit qytetar për "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Zonat e Mbrojtura" në Qarku Kukës për Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës" Ky kalendar të zhvillimeve të aktiviteteve për periudhë 2 vjeçare. Kryetar i forumit u zgjodh me konsensus të plotë znj ing Anila Hykaj dhe sekretar z. Astrit Metaliaj

27.09.2018, dhe 28.09.2018, zhvilluam e aktivitet mbi krijimin e modeleve të reja për zhvillimin e aktiviteteve të reja eko-turistike në qendren turistike të Parkut Kombëtar "Lugina e Valbonës" dhe Parkun "Korab-Koritnik" Gjate zhvillimit të këtij aktiviteti bëm aplikimin e materialeve promovuese dhe prezantuam atraksionet që zona e Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës dhe PN korab – Koritnik" ofron.

29.09.2018 u realizua produkti mediatik në Zonat e Mbrojtura të Qarkut Kukës përkatesisht në dy ZM (Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës" dhe Parku Natyror "Korab-Koritnik" që është përfshirë në projekt. Po kështu është bërë montazhi i këtij dokumentari në studio Tv Kukës. Bashkangjitur raportit edhe një kopje e dokumentarit dhe emisionit ku u realizua trasmetimi dhe disponojmë një kopje në CD.

Në datë 05.10.2018 shoqata "Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit" në kuader të programit: Mbeshtetje për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Shqipëri (SENIOR II), organizoi ngritjen e Forumit Lokal Mjedisor për Parkun Natyror Korab-Koritnik në Njesinë Administrative Shishtavec (Pjesë e Parkun Korab-Koritnik), Bashkia Kukës në kuader të projektit: "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të

qendrueshem te burimeve dhe vlerave natyrore ne zonat e mbrojtura". Ne kete krijim te Forumit Lokal Mjedisor moren pjese perfaqesues nga NGO lokale, ADZM, ekspert lokal dhe operatore lokal qe do te sherbejne si nje strukture lokale profesionale e gatshme per te marre pjese ne proceset advokuese dhe keshilluese prane strukturave vendore pergjegjese per menaxhimin e burimeve natyrore. Gjithashtu u zgjodhen organet drejtuese te Forumit Lokal Mjedisor me konsensus te plote, ku si kryetar u zgjodh Agim Noka dhe si sekretar Sami Mata. Pas ngritjes se forumit u miratua



kalendari i aktiviteteve per periudhen 2-vjecare. Ne bashkepunim me ADRZM dhe me shoqatat partnere monitoruam nje pjese te Parkut Natyror "Korab-Koritnik".

- ❖ Arritjet dhe produktet
- ✓ Pisha të mbjella 1000 fidan. Në PK Divjak 500 dhe 500 copë ne Parku Natyror Korab

Koritnik

- ✓ Ngritja e dy Forumeve Lokal Mjediore, funksionon me rregullore dhe statut me vete, për Parku Kombëtar "Lugina Valbonës" drejtues Anila Hykaj, sekretar Astrit Metaliaj, Për Parku Natyror "Korab Koritnik" me drejtues z. Agim Noka dhe sekretar Sami Mata. Ku eshte hartuar kalendari aktiviteteve në komunitet për advokimin e çështjeve mjedisore per dy ZM.
- ✓ 600 cope 2 modele fletepalosje me mesazhet ndergjegjesuese per mbrojtjen e 2 ZM të Projektit(Parku Kombëtar "Lugina Valbonës dhe Parku Natyror Korab Koritnik.)
- ✓ Përfshirja e komunitetit lokal në qarku Kukës, lidhur me vendim-marrjen mbi menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore ne dy ZM eshte vlersuar.
- ✓ Krijimi i modeleve të reja për zhvillimin e aktiviteteve të reja eko-turistike ne qendren turistike te Parkut Kombetar "Lugina e Valbones" dhe Parkun "korab-Koritnik" Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti bem aplikimin e materialeve promovuese dhe prezantuam atraksionet që zona e Parku Kombëtar "Lugina e Valbonës dhe PN korab – Koritnik" ofron.
- ✓ Nje Dokumentar televiziv për promovimin e veçorive të 2 ZM (Parku Kombëtar "Lugina Valbonës dhe Parku Natyror Korab Koritnik.)

❖ **Organizata: Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës**



Transboundary FORUM of Shkodra - Shkoder Lake

Zbatimi i projektit është mbështetur ne metodën e bashkëbisedimit nder-aktiv me aktorët dhe komuniteti ne rajonit te ZM përmes organizimit të takimeve informuese mbi mbi gjetjet, vleresimet dhe rekomandimet per minimizimin e impakteve negative në ZM Liqeni I Shkodres dhe Lumi Buna.

Takimet informuese janë organizuar dy llojesh individuale dhe komunitare. Takimet individuale jane mbajtur me drejtuesit e institucioneve pergjegjese per menaxhimin e ZM dhe autoritetet locale konkretisht (*AdZM, Bashkia Shkoder- Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, Bashkia Malesi e Madhe – kryetari, NJA Velipoje*).

Takimi informues me actor dhe target grupe te interesit eshte mbajtur me aktore vendore, OSC, ekspert dhe perfaqesues tekomuniteteve qe jetojnë pranë brigjeve te ZM dhe qe konsiderohen si përdoruesit kryesorte burimeve te ZM.Takimi eshte organizuar neshkoder me 22. 06. 2018. Takimet e ketij lloji kane sherbyer perprezantimin e problematikave që jane evidentuar dhe publikuar ne raportinkombetar "Vleresimi Analizimi dhe Hartzimi i impakteve negative ne ZM.

- ❖ Aktivitete te realizuara
- ✓ Takime individuale informuese individuale jane zhvilluar me drejtorin e AdZM(z. Agim Dardha);Drejtoreshene Drejtorise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimitte Ujerave (znj. AidaShllaku), kryetarin e Bashkisë se Malësisë se Madhe (z.ToninMarinaj) si dhe drejtuesin e NJA Velipoje z.Mark Llaloshi për prezantimin e gjetjeve, impakteve dhe rekomandimet per minimizimin e impakteve negative në ZM Liqeni I Shkodres dhe Lumi Buna. Keto takime jane mbajtur gjate muajit Prill 2018 nga stafi i menaxhimit te projektit(*Atrida Ferketi dhe Indira Kruja*)
- ✓ Ngritja egrupit te eksperteve lokal per advokim. Ne kuader te ketij aktiviteti, FSLS ka ngritur grupin e eksperteve lokal i cili ka qene pjese e takimeve lokale qe jane zhvilluar me autoritetet dhe perfaqesuesit e institucioneve pergjegjese per menaxhimin e ZM. Projekti synoj ngritjen e nje grupi local me eksperte te fushes se mjedisit dhe OSC te cilet kane advokuar per reduktimin e presionit te impakteve negative ne zone dhe frenimin e degradimit te metejshem te ekosistemit. Ne kete kontekst, ekspertet e kontraktuar kane organizuar takime me autoritete, perfaqesues te institucioneve menaxhuese, shoqata te shoqerise civile, drejtues te institucioneve educative, mesues, dhe pedagog te universitetit Luigj Gurakuqi me qellim evidentimin e mangësive në përfshirjen efektive të komunitetit lokal dhe pushtetit vendor në proceset e vendim-marrjes në ZM Liqeni I Shkodres dhe Lumi Buna.

- ✓ Përgatitja e broshures informuese mbi impaktet negative ne ZM Liqeni i Shkodres dhe Lumi Buna.
- ✓ Pas finalizimit te sondazhit mbi shqetesimet dhe problematikat e ZM, u pergatit lista finale e shqetesimeve dhe problematikave te ekosistemit Liqeni i Shkodres – Lumi Buna e cila u dezinjua ne formen e nje broshure informative per aktoret e qarkut Shkoder gjate fazes se pare te implementimit te projektit. Broshura eshte printuar ne 200 kopje dhe ka sherbyer si material informativ ne te gjitha takimet e organizuara ne kuader te ketij projekti.
- ✓ Takimi hapur informues ne Shkoder. Informimi I paleve të interes mbi gjetjet, vleresimet dhe rekomandimet per minimizimin e impaktit negative ZM Liqeni I Shkodres dhe Lumi Buna eshte mbajtur me 22 Qershor 2018. Ky takim synoj rritjen e treguesve te bashkëpunimit gjithëpërfshirës, angazhimit te autoriteteve vendore dhe konsultimin mbi reduktimin e sfidave te impakteve negative dhe niveleve kritike per te parandaluar degradimin e metejshem te ZM ne qarkun e shkodres.
- ✓ Angazhim qytetar ne aksione konkrete. Ne kuader te ketij aktiviteti RrMN eshte perfshire ne aksionin kombetar "Te pastrojme token qe duam". Ky aksion u mbajt ne kuader te *Dites Se Tokes Me 22 Prill 2018*. Eventu I dites se tokes u organizua me kontributin e gjithe anetareve te RrMN. Ne kete event, FSLs mori pjese ne organizimin e eventit I cili u parashikua dhe u mbajt ne ZM Divjake– Karavasta, blerjen e fidaneve per mbjellje, organizimin e pjesemarrjes ne aksion etj.
- ✓ Angazhimi qytetar ne aksione konkrete ka vijuar me te njeten metodologji edhe ne ZM Liqeni I Shkodres – Lumi Buna. Ky aktivitet ka startuar me takime te perbashketa me AdZM Shkoder me qellim bashkerendimin e aktivitetit bazuar ne prioritetet e ketij institucioni dhe planet e tyre per mbjelljen e fidanave. Ne te njeten kohe kemi ndermarre takime me drejtorite e shkollave dhe kete radhe me shkollen e mesme pyjore Kol Margjini.
- ✓ Advokim i grupit te eksperteve local. Gjate fazes se dyte te implementimit te ketij projekti, grupi i eksperteve te kontraktuar kane organizuar takimeve informuese/konsultuese mbi problematikat e evidentuara mjedisore ne ZM Liqeni i Shkodres – Lumi Buna. Ne kete kuader jane mbajtur dy takime me deputet te qarkut te shkodres z. Luan Harusha per bashkine Shkoder dhe z. Paulin Sterkaj per bashkine MM.
- ✓ Forumi Lokal i ZM. Ne vazhden e aktiviteteteve te Rrjetit per Mbrojtjen e Natyres e perms tij Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodres ishte edhe ngritja e nje forumi

lokal per ZM liqeni i Shkodres – Lumi Buna. Me qellimin e mire te angazhimit te aktoreve me aktiv dhe me ndjeshmeri ndaj mbrojtjes se mjedisit, FSLs ka zhvilluar takime me perfaqesues te Bashkive Shkoder e Malesi e Madhe, specialiste te mjedisit prane Prefektures Shkoder, specialiste te AdZM, pedagoge te Universitetit Luigj Gurakuqi, operatore lokale si dhe aktore te tjere te interesuar te shoqerise civile dhe OJF-ve gjate gjysmes se dyte te korrikut dhe dhjetediteshin te pare muajit gusht. Ngritja e ketij forumi eshte finalizuar me nje takim te perbashket ne ambjentet e zyres se FSLs OSC ne Shkoder ku moren pjese 11 pjesemarres.

- ✓ Permiresimi i infrastruktures informuese dhe pamore te qendres se informacionit ne rezervatin natyror te velipojes. Ky aktivitet eshte realizuar perms angazhimit te te rinjve te universitetit Luigj Gurajkuqi dhenxenesve te shkolles 28 Nentori ne Shkoder. Qellimi kryesor i ketij aktiviteti ishte pergatitja e ekspozites fotografike me fokus "Fauna e ZM Liqeni i Shkodres – Lumi Buna".Per pergatitjen e kesaj ekspozite jane angazhuar rreth 20 te rinj te cilet nen drejtimin e ekspertit local znj.

❖ Arritjet/rezultatet

- ✓ Gjetjet, impaktet dhe rekomandimet per minimizimin e impakteve negative në ZM Liqeni I Shkodres dhe Lumi Buna Jane prezantuar per autoritetet lokale dhe institucionet pergjegjese permenaxhimin e burimeve natyrore ne nivel rajonal;
- ✓ Palet e interesit jane informuar dhe pikat kritike qe kerkojne vemendje prioritare jane anonçuar ne 3 mediavizive;
<http://www.starplus-tv.com/ujerat-e-zeza-problem-per-liqenin-e-shkodres/>
- ✓ 200 kopje brochure informative jane shperndare per palet e interesura;
- ✓ Angazhimi qytetar ne aksione konkrete eshte arritur me kontributin e 60 te rinjeve nga qyteti I Shkodres ne PK Divjake –Karavasta;
- ✓ Te pakten 250 finadane pishe e bute jane mbjelle ne PK Divjake–Karavasta



- ✓ Angazhimi qytetar ne aksione konkrete ka krijuar qendrueshmeri permes krijimit te ngastrave te emertuara prane ZM Liqeni i Shkodres;
- ✓ Te pakten 400 fidanane pishe e eger (3 & 4 vjeçar) jane mbjelle ne malin e Taraboshit, parcela nr 12, me emer "Parcela Kol Margjini – Shkolla e Mesme Pyjore"
- ✓ Te pakten 35 aktorë, perfaqesues te institucioneve, autoritete lokale, OSC , mesues dhe perfaqesues te komunitetit kane diskutuar, debatuar dhe propozuar ndryshimin e statusit te mbrojtjes se zones me qellim menaxhimin me efektiv te saj;
- ✓ Eshte ngritur Forumi local i ZM me te paktem 6 anetar, perfaqesues te OSC ne Shkoder dhe ekspert te Universitetit te Shkodres.
- ✓ Niveli I vetëdijes qytetare është permiresuar permes angazhimit ne aksione konkrete dhe informimit te pikave kritike ne ZM Liqeni I Shkodres dhe Lumi Buna.
- ✓ Te paktën 3 media vizive kane ndjekur dhe transmetuar aktivite te ketij projekti duke rritur audience dhe informimin e qytetareve mbi problematikat e ZM dhe zbatimin e programit ne rajon
- ✓ Vizibiliteti I donatorit eshte arritur permes lancimit te eventeve, perfaqesimit te logove ne te gjitha materialet informuuese, ftesa, programe, bluza, etj tepergatitura enkasper keteprojekt.
- ✓ Rrjeti per mbrojtjen e natyres ne Qarkun e shkodres eshte zgjeruar me 2 shoqata te tjera me te cilat kemi lidhur marreveshje;
- ✓ FSLs ka rritur kapacitet profesionale, organizative dhe burimet njerezore vullnetare;

❖ Organizata Iliria



Datë 17.04.2018

Aktiviteti i parë ishte për mbjelljen e fidanëve pyjorë i cili u organizua në NJ.Administrative Zall-Bastar pjesë e Parkut Kombëtar të "Mali i Dajtit", më 17.04.2018 ku ishin 29 pjesëmarrës. Me anëtarë të OJF-së "ILIRIA" sëbashku me AdZM, Tiranë, nxënës të Shkollës "Bahri Nela", dhe punonjës të Njesisë Administrative Zall-Bastar, ku u bë e mundur mbjellja e 500 fidanëve pyjorë dhe bimëve dekorative, si dhe pastrimi i mbetjeve urbane.

Aktiviteti për Ditën Ndërkombëtare të Tokës, më 22 Prill 2018 të organizuar nga Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës (INCA) ku morën pjesë 34 pjesëmarrës nga OJF "ILIRIA", në bashkëpunim me, AdZM Fier, mësues, nxënës, vullnetarë, dhe komuniteti i zonës. ILIRIA bëri të mundur mbjelljen e rreth 500 fidanëve (Pishë e Butë) në Parkun



Kombëtar "Divjakë-Karavasta", dhe rreth 5000 në total nga të gjithë organizatat pjesëmarrëse, si dhe u punua për pastrimin e mbetjeve urbane në zonën e mbrojtur. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm gjithashtu përfaqësues nga Ministria e Mjedisit ku u mbajtën disa flalime me mesazhe të shkurtëra sensibilizuese për mjedisin, Drejtori i RrMN, Nihat Dragoti, Përfaqësues të Minitrisë, si dhe nxënës të shkollave 9 vjecare.

Kombëtar "Divjakë-Karavasta", dhe rreth 5000 në total nga të gjithë organizatat pjesëmarrëse, si dhe u punua për pastrimin e mbetjeve urbane në zonën e mbrojtur. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm gjithashtu përfaqësues nga Ministria e Mjedisit ku u mbajtën disa flalime me mesazhe të shkurtëra sensibilizuese për mjedisin, Drejtori i RrMN, Nihat Dragoti, Përfaqësues të

Aktivitet me 27/06/2018

Organizata ILIRIA gjithashtu mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga REC Shqipëri dhe INCA më 27 qershor 2018, në Parkun Kombëtar " Divjakë-Karavasta" me kërkesë të Ambasadës Suedeze në Tiranë, ku u diskutua për arritjet e deritanishme të programit të SENIOR II, projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura", ku organizata lider INCA bëri një rezymë të përgjithshme të asaj që është bërë, si dhe përfaqësuesit e organizatave të RrMN bënë një përmbledhje të punës së bërë nga secila prej tyre.

Aktiviteti i tretë

28/06/2018

Një aktivitet i organizuar në Njësinë administrative Dajt më 28 Qershor 2018 me përfaqësues të pushtetit vendor, Njësia Administrative Dajt, AdZM Tiranë, OJF Mjedisore, dhe përfaqësues nga komuniteti i zonës. Me pas me propozimin e organizatës ILIRIA u diskutua për krijimin e një Forumi Lokal, me përfaqësues të aktorëve të interesit, si përfaqësues të komunitetit (kryetar fshatrash, blegtorë, bujq, mesuese, gjuetar, etj), përfaqësues të Njësive Administrative, AdZM Tiranë, Biznesit, Zhvilluesve etj.

Aktivitete të tjera gjatë muajit Maj-Qershor ishin mbi: - Organizimin e sondazheve mbi evidentimin e mangësive në përfshirjen efektive të komunitetit lokal dhe pushtetit vendor në proceset e vendim-



marrjes, dhe evidentimin e problematikave sociale-mjedisore në PM "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh" dhe Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit".

- Është bërë formulimi dhe shpërndarja e një pyetsori të vecantë, për organizimin e sondazheve me qëllim evidentimin e problematikave, mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e situatës në të dy zonat e mbrojtura.

Një aktivitet i organizuar në Njësinë Administrative Zall-Bastar më 11 Korrik 2018 në Parkun Kombëtarë "Mali i Dajtit" me përfaqësues të pushtetit vendor, aktorëve të interesit, AdZM Tiranë, Këshillin e NJ.A dhe përfaqësues nga komuniteti i zonës. Ku u diskutua mbi krijimin e Forumit Lokal Dajt dhe mënyrës së funksionimit të tij.

Aktivitet më 09/10/2018

Një aktivitet i organizuar në njësinë administrative Martanesh-Bashkia Bulqizë me përfaqësues të Pushtetit Vendor, aktorëve të interesit, AdZM Bulqizë, dhe përfaqësues nga komuniteti i zonës. Qëllimi i aktivitetit ishte diskutimi dhe konsultimi mbi problematikat mjedisore dhe social-ekonomike që përballet komuniteti i zonës në Peisazhin e Mbrojtur "Mali me Gropa-Bizë-Martanesh". Rritjen e përfshirjes së komunitetit dhe OSHC-ve lokale, dhe pushtetit vendor në vendim marrje mjedisore dhe adresimi i zgjidhjes së këtyre problematikave në instancat përkatëse menaxhuese, kontrolluese.

Aktivitet per kroniken ne tv

Aktivitet i organizuar nga shoqatar ILIRIA, në kuadër të programit SENIOR II, i zbatuar nga REC-Albania dhe financuar nga Qeveria Suedeze (Ambassy of Sweden Tirana).

Projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura" faza e (II), shoqata ILIRIA ndërmerr një fushatë promovuese për vlerat eko-turistike në PK "Mali i Dajtit", duke përgatitur një kronikë televizive me gazetarë të RTSH, z. Marash Mirashi, që do të shfaqet te emisjoni Hapësirë e Blertë në TVSh.

❖ Rekomandime

Duhet rritur ndërgjegjësimi dhe kapacitetet e komunitetit për rëndësinë e ZM, menaxhimin dhe aksesin në vendimmarrje i cili ka një efekt domethënës në përmirësimin e gjendjes mjedisore, social-ekonomike.

Institucionet e të gjitha niveleve duhet të marrin në konsideratë, në angazhimet dhe politikat e tyre të administrimit dhe menaxhimit të ZM, për të siguruar shkëmbimin e informacionit, pjesmarrjen, dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve që vijnë nga burimet natyrore ndërmjet komunitetit i cili varet direkt nga këto burime.

Agjensia e menaxhimit të zonave të mbrojtura të përfshijë publikun dhe aktorët e interesit në planet e zhvillimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura, pasi ato preken direkt nga këto aktivitete. Përfaqësues të komunitetit duhet të përfshihen në

aktivitetet, programet, diskutimet, për të dhënë komentet e tyre në draft plane menaxhimi, të kenë përfaqësuesit e tyre në komitetin e menaxhimit, forumet lokale, në takimet publike dhe me pushtetin vendor etj.

Një rol të rëndësishëm duhet luajë OSHC-mjedisore ku të bëjnë më shumë për ndërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella mes komunitetit dhe institucioneve vendimmarrëse, të ndërgjegjësojnë komunitetin mbi rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe zonës së mbrojtur ku ata jetojnë.

Të shtohet numri i programeve të trajnimit për ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteve të komunitetit të ZM, për hapjen iniciativave të reja të prodhimit dhe shitjes produkteve të zonës dhe nxitjes së ekoturizmit.